



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Termet e Referencës

Pozicioni:	Manaxher Projekti SERENY
Vendodhja:	Shqipëri
Fillimi i Punës:	01.04.2022
Mbarimi i Punës:	15.10.2023
Kohëzgjatja:	6.5 muaj

Projekti

Institucioni kushtetues i Avokatit të Popullit, njëkohësisht institucioni kombëtar për të drejtat e njeriut me Status A, dhe në rolin e vet si Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, është përzgjedhur si Institucioni shqiptar partner për projektin nr. 101007425 SERENY "*Forcimi i qasjeve për parandalimin e radikalizimit të të rinjve në mjediset e burgut dhe të shërbimit të provës*" (*Strengthening approaches for the prevention of youth radicalisation in prison and probation settings*), mbështetur nga Programi Drejtësisë i BE-së.

Projekti 2-vjeçar SERENY "Forcimi i qasjeve për parandalimin e radikalizimit të të rinjve në mjediset e burgut dhe të shërbimit të provës " në shtatë vende anëtare të BE-së (IT-ES-AT-SLO-DE-FR-BE) dhe Shqipëri, synon të promovojë miratimin e ndërhyrjeve efektive, të bazuara në fakte, në lidhje me parandalimin e proceseve të radikalizimit tek të dënuarit e moshës së re, duke respektuar të drejtat e tyre të njeriut të garantuara nga ligjet dhe rregulloret ndërkombëtare të BE-së dhe të KiE.

Objektivi

Menaxheri i projektit do të duhet të njihet me projektin dhe ecurinë e deritanishme, të dokumentojë zhvillimet e të sigurojë suksesin e projektit në përputhje me kalendarin e miratuar të aktiviteteve, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e Institucionit për mundësimin e gjithë aspekteve të lidhura me prokurimet, rekrutimet e ekspertëve, etj.

Menaxheri do të jetë pjesë e Ekipit të Menaxhimit të Projektit që përbëhet nga menaxherët e secilës organizatë partnere, me qëllim mbështetjen e Koordinatorit të Projektit në menaxhimin dhe koordinimin e aktiviteteve të parashikuara.

Komunikimi i vazhdueshëm dhe ndarja e informacionit midis partnerëve përgjatë projektit kryhet përmes mjeteve online të përdorura zakonisht (Google Drive, Dropbox, email, etj.). Menaxheri do të duhet të marrë pjesë në Takimet e Progresit, aktivitetet e tjera të përbashkëta, etj, për të monitoruar zbatimin e planit të punës sipas paketave të punës të parashikuara në grant dhe për të vlerësuar cilësinë e rezultateve.

Po ashtu, menaxheri do duhet të lehtësojë e mbikqyrë detyrën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Vlerësimit të projektit, detyrë për të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit është partneri përgjegjës në projekt.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Për sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit, do të kontraktojë një Manaxher Projekti i cili do të jetë përgjegjës për:

- Sigurimin e manaxhimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit efektiv të aktiviteteve të programit sipas Grant Marrëveshjes duke u fokusuar në arritjen e rezultateve të përcaktuara.
- Ndjekjen e ecurisë së punës sipas Paketave të Punës së Projektit dhe të komponentëve përkatës.
- Zbatimin në kohë cilësi dhe sipas standardeve të aktiviteteve të parashikuara në projekt (kryerjen e intervistave me të dënuarit dhe realizimin e përmbledhjeve në anglisht, kryerjen e fokus grupit dhe të përmbledhjes, tryezë e rrumbullakët, workshop, etj.).

- Lehtësimin e bashkëpunimit me palët e treta (Shërbimi i Provës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, etj.)
- Përgatitjen e kërkesave për avancimin e fondeve dhe/ose pagesat direkte.
- Monitorimin e shpenzimeve të buxhetit dhe mbajtjen e rekordeve të duhura të buxheteve të miratura të projektit apo rishikimet e tyre.
- Manaxhimin e gjithë dosjeve, dokumenteve, korrespondencave të projektit.
- Përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve të shpenzimeve dhe të statusit të buxhetit të projektit.
- Kryerjen e çdo detyre tjetër të ngarkuar nga grupi i punës për projektin pranë insitucionit të Avokatit të Popullit lidhur me projektin.
- Hartimin e Raportit Përfundimtar të Vlerësimit të projektit, detyrë për të cilën institucioni i Avokatit të Popullit është partneri përgjegjës në projekt.

Kriteret e veçanta

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë.
- Të ketë eksperiencë në kërkim infomacioni dhe hartim dokumentash/ raportesh.
- Të ketë eksperiencë në hulumtim implementim dhe menaxhim projektsh.
- Të ketë eksperiencë pune në fushën e të drejtave të njeriut.
- Të ketë zotërim të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar.
- Të ketë aftësi organizative dhe administrative.
- Të ketë standarde të larta të integritetit.

Aplikanti duhet të dorëzojë:

- Letër motivimi
- Curriculum vitae
- Cdo dokument shtesë që lidhet me aplikimin.

Afati i aplikimit: 23 Mars ora 16:00

E-mail: Burime.Njerezore@avokatipopullit.gov.al

Adresa: Avokati i Popullit, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 2, Tiranë.